



QENDRA PËR SHËRBIME STUDENTORE DHE KARRIERË

SEMINARE MBI KONCEPTIN E “LIRISË”, SLOVENI

Seminaret mbi konceptin e lirisë organizohen nga “**Klubi Libertarian**”, një think tank klasik liberal nga Slovenia. Këtë vit seminarët do të zhvillohen me datë **14-27 Shtator, 2010**.

Seminari i parë: “Kampi I Lirisë”

Seminar një javor, në të cilin do të diskutohen bazat historike, filozofike dhe ekonomike të shoqërive të lira.

Diskutimet në seminar do të trajtojnë tematika si:

- Teoria e drejtësisë,
- natyra e demokracisë liberale,
- shteti i së drejtës,
- mënyrat për forcimin e shoqërisë civile,
- fuqia e pushtetit si dhe kufizimet e tij.

Kush mund të merr pjesë

Studentë aktual si dhe studentë të cilët kanë diplomuar dhe që kanë dëshirë të kontribuojnë për forcimin e shoqërisë civile.

Koha e mbajtjes

14-20 Shtator, 2010

Vendi ku do të zhvillohet seminari

Hostel pod Voglom, Liqeni Bohinj, Sloveni; 60 km larg Ljubljanes

Seminari i dytë: Liria dhe tranzicioni

Poashtu seminar një javor, i dedikuar për studim të avancuar mbi konceptin e lirisë në shtetet e Europës Lindore dhe Qendrore, të cilët janë në tranzicion apo kanë kaluar fazën e tranzicionit.

Diskutimet në seminar do të trajtojnë tematika si:

- Institucionet politike dhe ekonomike
- Korrupsioni dhe transparenca e sektorit publik
- Tregu dhe morali
- Kapitalizmi
- Privatizimi i sukseshem përballë atij të deshtuar

Kush mund të merr pjesë

Studentë të diplomuar, bursist të rinj, profesionist të rinj si dhe studentë deridiplomik që janë në vitin e fundit të studimeve.

Koha e mbajtjes

22-27 Shtator, 2010

Vendi ku do të zhvillohet seminari

Hotel Jezero, Liqeni Bohinj, Sloveni; 60 km larg Ljubljanes

Shpenzimet

Seminari i parë “**Kampi i Lirisë**”: **150 Euro**

Seminari i dytë “**Liria dhe Tranzicioni**”: **200 Euro**

Shpenzimet përfshijnë : akomodimin, ushqimin, udhëtimin nga Kështjella e Bledit dhe Ujëvara Savica, aktivitete rekreative (kamping malor, vizitë e kanioneve etj.), librat si dhe materiale të tjera.

Shpenzimet e udhëtimit nuk përfshijnë shumën e caktuar më lartë.

Aplikimi duhet të plotësohet në mënyrë elektronike-online, më së voni deri më **1 Korrik-2010**, në webfaqen : **<http://www.liberty-seminars.com/application.html>**

Për më shumë informacion vizitoni webfaqen zyrtare të seminareve: **<http://www.liberty-seminars.net/show.php?choice=seminars>**